

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

S E S I O N I II

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E premte, 9 shtator 2011

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja – seksioni dygjuhësh

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në prozë.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dyja pjesët ka pyetje me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në pyetjet me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për pyetjet me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11a
Pikët											
Kërkesa	11b	12	13	14	15	16	17	18	19	20a	20b
Pikët											
Kërkesa	21	22a	22b	23	24	25a	25b	25c	25d		
Pikët											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**KADARE****Në studion dimërore****1**

Befas dritaret u trandën, jashtë po ndodhte diçka.
 U afrova të shoh, gjëmimet vallë ç'qenë.
 Gjethe të rrëzuara, si krahë zogjsh në një hata.
 Dhe një breshër si shtresa perlash mbulonte dhenë.

Ç'janë ato zonja, vallë, që shkundin qafat, atje lart,
 Që si breshër shkundin perlat, stolitë?
 Diçka ka ndodhur, padyshim diçka
 Në tokë, në qiell, në shpirtra.

Diçka ka ndodhur?
 Veç te ti përherë
 Në trurin tënd e jashtëzakonshme ngjan gjithçka.
 Kurse në të vërtetë
 Dimri erdh' në derë
 Kjo veç ka ndodhur e gjë tjetër s'ka.

2

Flokët gjysmë të ngrirë,
 Të ftohur krejt
 Si nga qendra e dimrit ti erdhe drejt.

Ca kokrriza breshëri
 Solle me vete që jashtë.
 Që kishe diçka nga qielli
 Kjo dukej haptas.

Diçka nga dritë e tij
 Opake, enigmatike.
 Kokrrizat e breshrit
 Shkrinin pikë-pikë.

Kështu fjalët e tua
 Shndërroheshin në dënesë
 Për të ngrirë sërish
 Në frizerin kujtesë.

4

Porsi çifuti i kthyer në fe tjetër
 Ia behu shiu i konvertuar në breshër.

Sa herë shiu në qelqe do trokasë
 Ti do vish këtu dhe në mos ardhsh.

Qofsh si muzikë, si pikëllim apo si kryq
 Unë do të njoh e do të çohem vrik.

Dhe si ai që guaskës perlën ia merr
 Nga muzika, kryqi a vdekja do të të nxjerr

Për pyetjet nga 1 deri në 6 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Kjo është një poezi: **1 pikë**
- A) intime
B) filozofike
C) peizazhi
D) shoqërore
2. Sinonimi i fjalës *befas* në vargun *Befas dritaret u trandën*, është: **1 pikë**
- A) padashje
B) padyshim
C) papritur
D) pastaj
3. Cili nga çiftet e mëposhtme krijon kundërvënie? **1 pikë**
- A) dënesë - kujtesë
B) normale – çudi
C) kryq – pikëllim
D) breshër - perla
4. Cila është figura e stilistikës që krijohet midis vargjeve të mëposhtme? **1 pikë**
- Kokrrizat e breshrit*
Shkrinin pikë-pikë.
- Dhe
- Kështu fjalët e tua*
Shndërroheshin në dënesë
- A) metonimi
B) alegori
C) simbol
D) paralelizëm figurativ
5. Kur poeti thotë: *Ç'janë ato zonja, vallë, që shkundin qafat, atje lart*, ai nënkupton: **1 pikë**
- A) zogjtë e dimrit
B) retë në qiell
C) avionë që mezi duken
D) degët e thara të pemëve
6. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur epitet metaforik? **1 pikë**
- A) Që si breshër shkundin perlat, stolitë
B) Dhe si ai që guaskës perlën ia merr
C) Flokët gjysmë të ngrirë
D) Për të ngrirë sërish/ Në frizerin kujtesë.

7. Cili është roli i dimrit në këtë poezi? A po përpiqet Kadare të na tregojë se si është koha apo ky përdorim ka një qëllim tjetër? Shpjegoni përgjigjen tuaj. **2 pikë**

8. Gjeni sinonimin e foljes *u trandën*. Cili është funksioni artistik i këtij përdorimi? **2 pikë**

9. Gjeni në pjesën e dytë dy detaje ose shprehje që shprehin thelbin e marrëdhënieve midis vajzës dhe poetit. **2 pikë**

10. Si mendoni, cili prej tyre mund të jetë fajtor për ftohjen e marrëdhënies midis tyre? Në cilat vargje jepet kjo ftohje dhe ç'raport krijojnë midis tyre ato (vargjet)? **3 pikë**

11. Identifikoni në këtë poezi një metaforë të shprehur me emër dhe një me folje.

a) metaforë e shprehur me emër: _____ **1 pikë**

b) metaforë e shprehur me folje: _____ **1 pikë**

12. Analizoni funksionin e krahasimeve në vargjet e mëposhtme, duke zbërthyer edhe mënyrën si shfaqet qëndrimi emocional i poetit përmes tyre. **4 pikë**

*Qofsh si muzikë, si pikëllim apo si kryq
Unë do të njoh e do të çohem vrik.*

*Dhe si ai që guaskës perlën ia merr
Nga muzika, kryqi a vdekja do të të nxjerr.*

PJESA II**Flober****Zonja Bovari (*fragment*)**

Mërzitja iu përhap nga një shqetësim më i këndshëm, shtatzënia e gruas. Sa më shumë afrohej afati i lindjes, aq më tepër e donte ai atë. Midis tyre krijohej një lidhje tjetër organike, dhe një si ndjenjë e pandërprerë e një bashkimi më të ndërlikuar. Kur e shihte së largu tek ece gjithë plogështi, kur e kishte ballë për ballë dhe e sodiste më me nge, kur lëshohej e kapitur në kolltuk, ai fluturonte nga lumturia, ngrihej, e puthte, i ledhatonte fytyrën me duar, e thërriste mamakë, e ftonte të vallëzonte, dhe, nxirrte nga goja, gjysme me të qeshur, gjysmë me të qarë, gjithfarë shakash përkëdhelëse që i vinin në mend. Shkrihej i tëri nga ëndja me mendimin që do të bëhej baba. Tani nuk i mungonte më asgjë. E njihte jetën mbarë e prapë dhe ishte shtruar në të këmbëkryq, pa e prishur terezinë fare.

Në fillim Emës i erdhi çudi e madhe, pastaj e pushtoi dëshira të çlirohej nga ajo barrë që të merrte vesh se ç'donte të thoshte të ishe nënë. Mirëpo, në pamundësi për të bërë aq shpenzime sa donte ajo, të kishte një djep si varkë, me perde të mëndafshita ngjyrëtrëndafili dhe kapuç të qëndisur, e pushtuar nga një valë hidhërimi, hoqi dorë fare nga takëmet e kalamanit, dhe i ra shkurt, duke i porositur ato te një rrobaqepëse e fshatit, pa i zgjedhur dhe pa bërë fjalë rreth tyre. Nuk u argëtua pra, me këto parapërgatitje që shtojnë dhembshurinë e nënave dhe qysh në fillim, dashurinë për foshnjën sikur ia zbehu diçka.

Megjithatë, meqë Sharli, sa herë që ulej e ngrihej nga buka, i fliste për fëmijën, s'kaloi shumë dhe ajo filloi ta kishte mendjen vazhdimisht aty.

Ajo e donte djalë; të ish i fortë e zeshkan dhe emrin ta kishte Zhorzh; dhe mendimi që të lindte një mashkull ishte për të si një shpresë për hakmarrje për gjithçka që s'kishte mundur të arrinte vetë në të kaluarën. Djali, të paktën, është i lirë; ai mund të kënaqë pasionet e veta e të bredhë nëpër vende të ndryshme, të kapërcejë pengesat, të shijojë lumturinë më të paarrtshme. Ndërsa vajza s'ka nga t'ia mbajë gjithë jetën. E ngordhur dhe delikate njëkohësisht, ajo duhet të përballojë edhe dobësitë e trupit të vet dhe nënshtrimin ndaj ligjit. Vullneti, ashtu si velloja e kapelës së saj që mbahet me një copë lidhëze, i lëkundet nga të fryjë era, gjithmonë e tërheq ndonjë dëshirë, gjithmonë e mban në vend ndonjë normë.

Lindi një të diel, rreth orës gjashtë, kur po dilte dielli.

- Vajzë! – tha Sharli.

Ajo ktheu kokën nga ana tjetër dhe i ra të fikët.

Për pyetjet nga 13 deri në 19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. “Zonja Bovari” është njohur si një roman: **1 pikë**
- A) romantik.
 - B) filozofik.
 - C) psikologjik.
 - D) simbolist.
14. *Objektivizmi* i Floberit shfaqet: **1 pikë**
- A) në shtjellimin delikat që i bën figurës së Emës,
 - B) në trajtimin e njëanshëm që i bën figurës së Sharlit.
 - C) në trajtimin e paanshëm që i bën të dy figurave
 - D) në zberthimin e figurës së femrës në përgjithësi.
15. Çfarë nënkupton *bovarizmi*? **1 pikë**
- A) dashuri dhe tradhti
 - B) dashuri dhe ëndërrim
 - C) jetë dhe vdekje
 - D) ëndërrim dhe zhgënjim
16. Fjala *këmbëkryq* është: **1 pikë**
- A) e thjeshtë
 - B) e përbërë
 - C) e përngjitur
 - D) e prejardhur
17. Emës i bie të fikët në fund të këtij fragmenti, sepse: **1 pikë**
- A) ndihet e sëmurë.
 - B) është e lodhur nga lindja.
 - C) nuk i pëlqen fakti që lindi vajzë.
 - D) ka frikë nga përgjegjësitë që e presin.
18. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur metafora? **1 pikë**
- A) Shkrihej i tëri nga ëndja me mendimin që do të bëhej baba.
 - B) Të ish i fortë e zeshkan dhe emrin ta kishte Zhorzh.
 - C) Midis tyre krijohet një lidhje tjetër organike.
 - D) Tani nuk i mungonte më asgjë.
19. Cili është fati i Emës në fund të romanit? **1 pikë**
- A) I pushon zemra.
 - B) Helmohet me arsenik.
 - C) Ndahet nga Sharli përfundimisht.
 - D) Floberi e lë të papërcaktuar.

20.

- a) Cila është ndjenja që përjeton Sharli kur mëson se do të bëhet baba? Ilustroni me një shembull raportin që ai ka me Emën në këtë moment. **2 pikë**

- b) Si mendon Sharli në lidhje me jetën që ka? Pse? **2 pikë**

21. Cilat janë tri ndjesitë që provon Ema kur mëson se do të lindë një fëmijë? **3 pikë**

22. Ema dëshiron të lindë djalë. Cilat janë sipas saj të paktën dy arsye që ajo nuk do që të lindë vajzë?

- a) _____ **1 pikë**

- b) _____ **1 pikë**

23. Shpjegoni se si edhe në këtë moment idetë romantike ndikojnë në jetën e Emës. Mendimin ilustrojeni me shembuj ose detaje nga fragmenti. **2 pikë**

24. Si reagon Ema kur merr vesh se lindi vajzë? A mendoni se ajo është e lumtur në këtë moment? Pse? **3 pikë**

25. Ema e krijon vetë burgun e vet përmes mendimeve dhe veprimeve të saj. A jeni dakord me këtë pohim? Argumentoni mendimin tuaj në formën e një eseje. **8 pikë**

Shtjellimi i idesë (25a)	Organizimi dhe struktura (25b)	Stili dhe origjinaliteti (25c)	Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d)	Totali
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë